



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 301

Ora: 12:00

VENDIM

**MBI PROCESIN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KRYETARËT E BASHKIVE
DHE LISTAVE SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAKË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie dhe të listave shumemërore për këshillin bashkiak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 33, shkronja “f” e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja “a”, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VËREJ:

Subjektet zgjedhore, në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiakë rezulton se, të dhënat e deklaruara nga kandidatët nuk përfshihen në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji nr. 138/2015.

Data: 5.4.2023 Nr: 301
Ora: 12:00



“Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e bashkive dhe listave shumemërore për këshillin bashkiak, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listave shumëmemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja "b" e 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatët për kryetar bashkie dhe kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiakë, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik, në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për kryetar bashkie dhe kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiakë, sipas së cilës rezulton se kandidatët nuk janë në kushtet e ndalimit dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiakë, të subjekteve zgjedhore (në lidhjet bashkëlidhur), nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Referuar nenit 33, shkronja "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ-të duhet të vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie dhe listave shumëmemërore për këshillat e bashkive, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillit bashkiak të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
2. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillit bashkiak të Koalicionit "Bashkë Fitojmë", për bashkitë sipas lidhjes 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
3. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca Arbnore Kombëtare", për bashkitë sipas lidhjes 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
4. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane", për bashkitë sipas lidhjes 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
5. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
6. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partisë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
7. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet", për bashkitë sipas lidhjes 7 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
8. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca Liberale e Djathtë", për bashkitë sipas lidhjes 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
9. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Bindja Demokratike", për bashkitë sipas lidhjes 9 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.



10. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Fryma e Re Demokratike", për bashkitë sipas lidhjes 10 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
11. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Aleanca Progresiste L.ZH.K", për bashkitë sipas lidhjes 11 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
12. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Lëvizja e Re", për bashkitë sipas lidhjes 12 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
13. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Lidhja Demokristiane Shqiptare", për bashkitë sipas lidhjes 13 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
14. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen", për bashkitë sipas lidhjes 14 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
15. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Nisma Thurje", për bashkitë sipas lidhjes 15 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
16. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 16 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
17. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Balli Kombëtar", për bashkitë sipas lidhjes 17 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
18. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Drejtësi, Integrim dhe Unitet", për bashkitë sipas lidhjes 18 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
19. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Demokracia Sociale", për bashkitë sipas lidhjes 19 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
20. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Emigracionit Shqiptar", për bashkitë sipas lidhjes 21 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
21. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia e Gjelbër", për bashkitë sipas lidhjes 22 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
22. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Lëvizja punëtore Shqiptare", për bashkitë sipas lidhjes 23 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.

23. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", për bashkitë sipas lidhjes 24 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
24. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Ora e Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 24 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
25. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorve të Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 25 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
26. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia e Reformave Demokratike Shqiptare", për bashkitë sipas lidhjes 26 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
27. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Demokratike", për bashkitë sipas lidhjes 27 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
28. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie dhe anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë", për bashkitë sipas lidhjes 28 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
29. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Kristian Demokrate e Shqiperise", për bashkitë sipas lidhjes 29 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
30. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Kombëtare Konservatore Albania", për bashkitë sipas lidhjes 30 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
31. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Lëvizja e Legalitetit", për bashkitë sipas lidhjes 31 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
32. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Republikane Shqiptare", për bashkitë sipas lidhjes 32 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
33. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Socialdemokrate", për bashkitë sipas lidhjes 33 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
34. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të "Partia Uniteti Kombëtar", për bashkitë sipas lidhjes 34 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
35. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Ardhmërija Shqiptare", për bashkitë sipas lidhjes 35 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.

36. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë “Ora e Shqipërisë”, për bashkitë sipas lidhjes 36 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
37. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të “Partia Komuniste e Shqipërisë”, për bashkitë sipas lidhjes 37 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
38. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për anëtarë të këshillit bashkiak të “Partia Konservatore”, për bashkitë sipas lidhjes 38 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe lejimin e kandidimit të tyre.
39. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
40. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI